



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 774/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.12.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e shoqërisë “Mega Plast 2L” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr. Ref-30208-10-18-2017 me objekt: *“Blerje materiale ndërtimi, me fond limit 2.892.010 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 30.10.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Selenicë.*”

Ankimues:

“Mega Plast 2L” sh.p.k
Nj.B Nr.8, Rr. “F.Xhajko”, ZK Nr.83/40, Ambienti nr.3/520,
Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Selenicë
Selenicë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 *“Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimes, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.10.2017 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr. Ref-30208-10-18-2017 me objekt: “*Blerje materiale ndërtimi, me fond limit 2.892.010 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 30.10.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Selenicë.*”

II.2. Në datën 14.11.2017 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar.

Sipas këtij klasifikimi renditja e ofertave pa TVSH, është si më poshtë:

- | | |
|---------------------------|---------------------------------|
| 1. “Mega Plast 2L” sh.p.k | 2.815.500,00 lekë, skualifikuar |
| 2. “Asi-2A Co” sh.p.k | 2.870.000,00 lekë, kualifikuar |

Operatori ekonomik “Mega Plast 2L” sh.p.k rezulton i skualifikuar me argumentat e mëposhtme:

“*Nuk plotësohet kriteri mbi dorëzimin e bilanceve. Në pikën 2, paragrafi 2 i dokumentave standarde kerkohet dorezim i bilanceve per vitet 2014, 2015, 2016. Ju nuk e keni bilancin e viti 2014.*”

II.3. Në datën 15.11.2017 operatori ekonomik “Mega Plast 2L” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij në procedurën e mësipërme e prokurimit. Në mënyrë të përmbledhur pretendohet si vijon:

“*[...] Arsyja pse nga ana jonë nuk është paraqitur bilanci për vitin 2014 e si rrjedhojë as xhiro për këtë vit, pasi referuar ekstraktit tregtar dhe atij historik që kemi paraqitur, subjekti ynë është*

themeluar në datën 25.03.2015, vit për të cilin kemi paraqitur dokumenta. Përderisa subjekti ynë nuk ka ekzistuar në vitin 2014, si rrjedhojë nuk kemi se çfarë të dorëzojmë dhe fakti që ne kemi vetëm 2 vjet që jemi krijuar, nuk na ndalon ligjërisht të marrim opjesë në cdo procedurë prokurimi për të cilat ne plotësojmë plotësisht kriteret, qoftë këto dhe me dokumentacion që kemi vetëm për një vit apo dy pasi me vlerën e xhiros që kemi e plotësojmë kriterin e limitit që keni vendosur [...].”

II.4. Në datën 30.11.2017 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime si edhe në autoritetin kontraktor. Gjithashtu pretendohet se nuk ka marrë përgjigje nga AK brenda afateve ligjore.

II.5. Në datën 11.12.2017 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1764/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 2837/1 prot., datë 06.12.2017 me objekt: *“Kthim përgjigje ankesës së subjektit “Mega Plast 2L” sh.p.k”, bashkëngjitur dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit.*

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Mega Plast 2L” sh.p.k me arsyetimin se *“Nuk plotësohet kriteri mbi dorëzimin e bilanceve (pasi) në pikën 2 paragrafi 2 i dokumentave standarde kërkohet dorëzimi i bilanceve për vitet 2014, 2015, 2016. Ju nuk e keni bilancin e viti 2014”,* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në Shtojcën 7 *“Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”* të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar plotësimin e kërkesës së mëposhtme:

“Kopje të vërtetuar të bilanceve per tre vitet e fundit (2014, 2015, 2016) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse dhe të certifikuara nga një organ i jashtëm licensuar për kontrollin financiar, (edhe në rastet e bashkimit të operatorëve duhet të ketë bilancin për secilin operator).”

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.), për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar dokumentacionin si vijon:

- Pasqyrat Financiare të Vitit 2015 të certifikuara nga organet tatimore.
- Pasqyrat Financiare të Vitit 2016 të certifikuara nga organet tatimore.
- Ekstrakt i Regjistrisë Tregëtare me anë të së cilës provohet se subjekti “Mega Plast 2L” sh.p.k është themeluar në datën 25.03.2015.

III.1.3. Në nenin nenin 46, pika 1, gërma “c” të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”,* i ndryshuar, parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”. “Gjendja ekonomike e financiare:*

operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilanci, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur”.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, pika 3, është përcaktuar:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Ndërsa në pikën 5, gërma “a” dhe “b” të këtij neni, thuhet se:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:

a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse: dhe/ose

b) kopje të deklaratave të xhiros vjetore, ku në asnjë rast, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet;

Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, sa i takon përmbushjes së kriterit të vecantë të kualifikimit lidhur me bilanci e viteve 2014, 2015 e 2016, konstatohet se operatori ekonomik ankimes “Mega Plast 2L” shpk ka paraqitur bilanci e viteve 2015 e 2016 të certifikuar nga organet tatimore. Referuar ekstraktit të regjistrit tregtar të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit rezulton se, operatori ekonomik “Mega Plast 2L” sh.p.k është regjistruar në regjistrin tregëtar shqiptar në datën 15.04.2015 dhe është themeluar në datën 25.03.2015, duke mos patur aktivitet për vitin 2014. Pra operatori ekonomik e ka pasur të pamundur paraqitjen e tij për shkak të mosekzistencës së tij si person juridik në këtë periudhë.

Komisioni vlerëson se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e

prokurimit. Në rastin konkret Komisioni gjykon se operatori ekonomik “Mega Plast 2L” shpk me anë të dokumentacionit të paraqitur ka dëshmuar se zotëron kapacitetet financiare përsa u përket bilanceve, të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës, sic parashikohet në nenin 46 të LPP-së si më sipër cituar.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimese qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Mega Plast 2L” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr. Ref-30208-10-18-2017 me objekt: "*Blerje materiale ndërtimi*, me fond limit 2.892.010 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 30.10.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Selenicë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Mega Plast 2L” sh.p.k dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë ofertues.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Mega Plast 2L” sh.p.k” sh.p.k
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1764 Protokoli,

Datë 30.11.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Leonard Gremshi	Hektor Balluku	Kleves Janku	Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha